



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,  
Qershorë 2016

# ASPEKTE MBI POZITËN PROCEDURALE TË PERSONIT TË TRETË NË PROCESIN GJYQËSOR CIVIL

**Ergys Gashi**

**Shkolla e Magjistraturës**

*Adresë kontakti: [ergys\\_gashi@yahoo.com](mailto:ergys_gashi@yahoo.com)*

## **Përmbledhje**

Personi i tretë është subjekt me rol të kufizuar në procesin gjyqësor civil, të drejtat procedurale të të cilit nuk shtrihen deri në disponimin e gjykimit apo të objektit të padisë.

Ai ndërhyt ose thirret në një çështje gjyqësore në vazhdim, duke u pozicionuar në mënyrë të caktuar ndaj palëve, dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit, të tretit ose palës, në përputhje me të drejtën civile materiale, mund t'i jepet mundësia juridike për të iniciuar një çështje gjyqësore pasardhëse, në të cilën të reflektohet mënyra e përfundimit të çështjes paraardhëse.

Kufizimi i të drejtave të personit të tretë vetëm në veprimet që nuk përbëjnë disponim të objektit të padisë, është menduar nga ligjvënësi t'i përshtatet kufizimit të të drejtave procedurale të ndërhyrësit dytësor. Atëherë kur pala e mbështetur prej ndërhyrësit dytësor ka humbur interesin për ta ndjekur çështjen, rezulton se vullneti i ndërhyrësit dytësor nuk do të ishte i mjaftueshëm pa iu bashkëngjitur atij të palës që ai mbështet.

Personi i tretë, duke mos qenë 'palë' në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, nuk mund të ngarkohet me detyrime, sipas dispozitivit të vendimit përfundimtar të gjykatës. Por sa u takon përfundimeve në të cilat arrin gjykata në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, këto përfundime të gjykatës sjellin pasoja të caktuara për të tretin, të cilat shndërrohen nga gjendja e tyre potenciale në gjendjen efektive, vetëm kur i tretë ose pala vendos të iniciojë çështjen pasardhëse gjyqësore.

**Fjalë çelës:** person i tretë, proces gjyqësor civil, palë, të drejta procedurale të kufizuara, efektet e vendimit përfundimtar.

## *ASPECTS ON PROCEDURAL POSITION OF THIRD PARTIES IN CIVIL LITIGATION PROCESS*

### **Abstract**

Third parties are persons with a limited role in civil litigation process, whose procedural rights do not encompass controlling the litigation or the civil lawsuit.

He intervenes or is summoned in an ongoing civil litigation process and positions oneself in a certain manner towards existing parties. Depending on the final result of the case, he or the respective party may be acknowledged a right, grounded on private substantive law, to initiate a further civil process. In the latter process, the way the former process ended, may be reflected.

Limiting third-parties' rights to acts not constituting control of the lawsuit's subject, has been envisaged to better suit the limited procedural rights of the accessory intervenor. When the party aided by the accessory intervenor has lost interest in the process, the intervenor's will to go on with the case shall not be sufficient without leaning on that of the principal party.

By not being a 'party' to the process, under a strict understanding of this concept, the third party may not be charged with obligations included in the imperative section of the judgement. Nevertheless with regard to conclusions reached by the court in resolving a lawsuit, these court conclusions have certain effects on third parties and transform themselves from a potential state to an effective one, only when the third party or the principal one, decides to initiate a subsequent civil process.

**Keywords:** Third parties, civil litigation process, parties, limited procedural rights, effects of final judgement.

## Hyrje

Personi i tretë është një subjekt i procesit civil, me të drejta dhe detyra procedurale të njëjta me ato të palëve, përjashtuar këtu ato që përbëjnë disponim të objektit të padisë. Në këtë kuptim ai është një pjesëmarrës i procesit, me rol të kufizuar, në atë masë që nuk cenon pozitën dhe veprimet procedurale të palëve që ai gjen në proces. Në momentin kur i treti bëhet pjesë e procesit, ky i fundit është në vazhdim në shkallë të parë, pavarësisht se në cilën fazë është procesi. Ajo që kuptohet me këtë është se faza më e shtyrë e procesit në të cilën mund të lejohet pjesëmarrja rishtas e të tretit, është ajo në të cilën hetimi gjyqësor nuk ka përfunduar ende, e pra ku i treti mund të paraqesë shpjegime dhe eventualisht prova. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pasur rast të theksojnë se jo vetëm i treti nuk mund të konstituohet rishtas në gjykim në shkallë të dytë, por as nuk është i mundur ndryshimi i pozitës së të tretit, që në shkallë të parë ishte konstituuar si ndërhyrësor dytësor, në ndërhyrës kryesor në shkallë të dytë.<sup>1</sup> Në sens të kundërt ndonjë qëndrim në doktrinë<sup>2</sup>, sipas të cilit 'ndërhyrja dytësore', për shkak të rolit dytësor që ka gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes, do të ishte më e përshtatshme të realizohej edhe në gjykatën e apelit. Më tepër ky duket një sugjerim për amendim në Kod sesa një pasqyrim i gjendjes ligjore aktuale.

Përgjatë punimit flitet për çështje gjyqësore kryesore, gjë që nënkupton mundësinë e një çështjeje gjyqësore pasardhëse. Ky raport midis dy procesesh gjyqësore shënon karakteristikën bazë të zhvillimit kronologjik të marrëdhënieve procedurale midis palës dhe personit të tretë: nëse pala mbetet e pakënaqur nga përfundimi i procesit gjyqësor (e humbet çështjen), ajo mund t'i drejtohet gjykatës, duke iniciuar një proces të ri, në të cilin si paditës figuron ajo vetë dhe si i paditur personi i tretë në gjykimin e mëparshëm.

## Mbi shfaqjet e ndryshme të personit të tretë në gjykim

I treti mund: *i)* të ndërhyjë vetë në proces; ose *ii)* të thirret nga pala e interesuar për këtë ose nga gjykata. Në rastin e parë pjesëmarrja e të tretit cilësohet nga ligji si ‘ndërhyrje’, e degëzuar në:

- ‘Ndërhyrje kryesore’, kur i treti paraqet kërtime të pavarura nga ato të palëve, me kushtin që ato të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e gjykimit (bëhet fjalë për objektin që qëndron në themel të gjykimit; objektin në kuptimin thelbësor, material, konkret, p.sh. sendin apo të drejtën; nuk e kemi fjalën për objektin e padisë, si mënyrë e parashtrimit të një kërkitimi gjyqësor). Kjo lidhje në këtë rast nuk është e çfarëdoshme - është më e drejtpërdrejtë se ajo që karakterizon ‘padinë’ dhe ‘kundërpadinë’ në vështirësi të n. 160 të Kodit të Procedurës Civile (*këtu e në vijim K.P.C.*)<sup>3</sup>. I treti e kërkon për vete tërësisht ose pjesërisht sendin ose të drejtën që është objekt i gjykimit ose që lidhet me përfundimin e gjykimit. Lidhja është me sendin ose të drejtën përkatëse, nuk është një lidhje midis dy kërkitimeve (atij që ndërhyrësi gjen në proces dhe atij që ai parashtron rishtas). Për këtë aspekt nuk kanë munguar edhe mendime të kundërt në doktrinë, sipas të cilëve: “*padia e personit të tretë që kërkon të realizojë ndërhyrje kryesore, duhet të ketë të njëjtin objekt me padinë fillestare (kryesore) ...*”<sup>4</sup>.

Gjithsesi ne i mbetemi qëndrimit tonë, sipas të cilit kërkitimi i ndërhyrësit kryesor mund të jetë relativisht i palidhur me natyrën e kërkitimit që ai gjen në proces, mjafton që kërkitimi i tij të drejtohet drejtpërdrejt tek sendi apo e drejta subjektive në të cilën është drejtuar drejtpërdrejt edhe kërkitimi i paditësit të mëparshëm.

Ndërhyrja kryesore realizohet duke ngritur ndërhyrësi padi kundër njëres ose të dyja palëve që gjen në proces. Për qëllime doktrinare mund të bëjmë edhe interpretimet si vijon. Ndërhyrjen kryesore mund ta cilësonim ‘të mirëfilltë’ atëherë kur ndërhyrësi padit njëren ose të dyja palët, me kushtin bazë sipas të cilit ndërhyrësi të rezultojë i shkëputur nga çfarëdo pozite juridike e përbashkët me cilëndo prej palëve. Kjo mund të ndodhë edhe kur ndërhyrësi padit vetëm njëren prej palëve, jo sepse e ‘kursen’ për shkak të bashkëzotërimit të situatave subjektive që ka me të (këto situata mungojnë), por sepse mund të ndodhë që vetëm njëra prej palëve të legjitimohet materialisht për të qenë e paditur (vetëm ajo është shkaktare e gjendjes së faktit që i kundërvihet të drejtës së tij subjektive).

Por në situata të tjera të posaçme, ndërhyrësi kryesor është bashkëtitullar i një pozite juridike subjektive me njëren prej palëve. Në këtë rast ai padit palën tjetër, ‘*duke pretenduar për vete pjesërisht sendin ose të drejtën*’, po të flisnim me gjuhën e nenit 189 të K.P.C.. Për të qenë konkretë, i tillë mund të jetë rasti i një gjykimi që zhvillohet sipas neneve 94, shkronja ‘c’ (‘*personi jo i ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tij*’), 349 (‘*padia për kërkitimin e trashëgimit*’) të Kodit Civil, në të cilin padia për të kundërshtuar veprimin juridik (d.m.th. veprimin e tjetërsimit të pasurisë trashëgimore nga trashëgimlënësi përpara vdekjes, por në gjendje mendore të diskutueshme) është ngritur nga vetëm njëri prej trashëgimtarëve. Trashëgimtari tjetër ngre të njëjtën padi kundër të paditurit, duke kërkuar të përfshihet në të njëjtin gjykim. Këtë formë të ‘ndërhyrjes kryesore’ do të mund ta cilësonim si ‘*e bashkëngjitur autonome*’ (e quajtur ndryshe ‘*ndërhyrje bashkëndërgjyqëse*’): interesat e dy paditësve që janë paraqitur veçmas njëri-tjetrit në proces, janë të njëjta dhe paralele; veprimet e tyre procedurale, nëpërmjet ngritjes së padisë dhe ato gjatë gjykimit, synojnë

arritjen e të njëjtit rezultat – pavarëshmërinë e veprimit juridik dhe kthimin e trashëgimit. Por kjo ‘bashkëngjitje’ është virtuale, në kuptimin që ata nuk janë në gjendje të kushtëzojnë në asnjë mënyrë veprimet procedurale të njëri-tjetrit; në këtë kuptim ‘bashkëngjitja’ cilësohet si ‘autonome’.

Parë nga këndvështrimi i mbrojtjes më të mirë të interesave të paditësve, ndërhyrësi kryesor në pozitën ‘e bashkëngjitur autonome’ vjen në proces për të parashtruar më mirë kërkimet në aspektin formal dhe substancial, dhe ç’është më karakteristike, është në tagrin e tij të paraqesë një arsye tjetër të kërimit (*causa petendi*), të zgjerojë shkakun ligjor, p.sh. sipas situatës hipotetike të sipërpërmendur, të pretendojë jo vetëm mungesën e ndërgjegjes së trashëgimlënësit për rëndësinë e veprimeve, por edhe rrethanën e ‘kanosjes’ sipas n. 94, shkronja ‘ç’ të Kodit Civil.

- ‘Ndërhyrje dytësore’, kur i treti mjaftohet të mbështesë ose ndihmojë njërën prej palëve, me të cilën bashkohet në gjykim. Në këtë kuptim pozita e ‘ndërhyrësit dytësor’ është më e ulët (inferiore) sesa ajo e ‘ndërhyrësit kryesor’ të sipërpërmendur, dhe ndërhyrja dytësore cilësohet në doktrinë si ‘*ndërhyrje e bashkëngjitur e varur*’. Duke u ndodhur para një pozite dytësore, të bashkëngjitur dhe më të ulët të ‘ndërhyrësit dytësor’ ndaj palës që ai mbështet, bën të lindë edhe nevoja për sqarime mbi mundësitë procedurale që ndërhyrësi ka për ta ndjekur çështjen edhe përtej vullnetit të palës së mbështetur. Kjo problematikë do të trajtohet konkretisht në vazhdim të punimit.

Në doktrinë janë shfaqur edhe mendime, sipas të cilave kërkesa ligjore ndaj ndërhyrësit dytësor, për ‘mbështetje dhe ndihmë’, nuk duhet kuptuar në mënyrë shumë strikte: “*Ndërhyrja e tij nuk favorizon në mënyrë të drejtpërdrejtë palën së cilës i bashkohet, madje shpesh ndërhyrësi dytësor ndërhyr në proces vetëm për të mbikëqyrur sjelljen e vetë palës së cilës i bashkohet në proces dhe qëllimi i tij është që të evitojë që mbrojtja e paefektshme e palës së cilës i bashkohet, të reflektojë në mënyrë të dëmshme mbi pozicionin e tij.*”<sup>5</sup>

Në rastin e dytë (të thirrjes, jo të ndërhyrjes spontane), i treti thirret nga njëra ose tjetra palë<sup>6</sup>, ose përndryshe nga gjykata<sup>7</sup>. Kur i treti thirret dhe nuk ndërhyr spontanisht në proces, pjesëmarrja e tij cilësohet e ardhur përmes të ashtuquajturës ‘ndërhyrje e detyrueshme’. Për këtë rast në doktrinë është evidentuar se: “*Nuk bëhet fjalë për një detyrim fizik apo juridik. Detyrimi ka të bëjë vetëm me faktin se pjesëmarrja në gjyq nuk bëhet spontanisht.*”<sup>8</sup>

Ajo që vlen të trajtohet në këtë kuadër është se cila është pozita thelbësore e ‘ndërhyrësit dytësor’ krahasuar me atë të ‘të thirrurit nga pala’. Ajo që i bashkon të dyja figurat është se nuk parashtrajnë kërtime të drejtpërdrejta të vetat ndaj objektit të gjykimit (sendit ose të drejtës), pra nuk konfigurohen në gjykim si paditës (ashtu siç pamë për ndërhyrësin kryesor). Megjithatë midis të dyja figurave ka një ndryshim me rëndësi. I thirruri shfaq një pavarësi relative më të madhe nga pala thirrëse sesa ajo që shfaq ndërhyrësi dytësor nga pala e mbështetur prej tij. Pozita procedurale e ndërhyrësit dytësor është e varur nga ajo e palës që ai mbështet; ai nuk mund të ndërmarrë veprime procedurale që do të cenonin pozitën procedurale të palës së mbështetur. Nëse ai do të synonte ta bënte këtë, me kundërshtimin e palës së mbështetur, këto veprime nuk do të duhet të lejoheshin nga gjykata ose efektet e tyre të zhbëheshin (zhvleftësoheshin).

Përkundrazi, i thirruri paraqitet në gjykim sipas një skeme të projektuar nga thirrësi, për shkak se ky i fundit mendon të bashkojnë forcat ndaj një të keqeje të përbashkët (d.m.th. pranimi/

rrëzimi i padisë do të dëmtonte drejtpërdrejt interesat e secilit prej tyre - e ashtuquajtura ‘*çështje e përbashkët*’), ose se thirrësi i paditur ndihet i detyruar sipas ligjit apo vlerësimit të tij subjektiv t’ia kundrejtojë formalisht (zyrtarisht) të thirrurit kërkimin e paditësit, duke shërbyer kjo thirrje si një mekanizëm garancie në dobi të thirrësit (e ashtuquajtura ‘*thirrje e të tretit për garanci*’). Pra në rastin e thirrjes së të tretit, secili prej tyre (thirrësi – i thirruri) bën ‘lojën’ e tij, qëndrimet e tyre nuk është e thënë të bashkërendohen në mënyrë të ngushtë. Me gjithë këtë pavarësi relative, si thirrësi, ashtu edhe i thirruri, kanë interes t’i shërbejnë arritjes së të njëjtit rezultat në gjykim (pranimi të padisë së paditësit, nëse i përkasin kësaj pale) ose rrëzimit të padisë (nëse i përkasin palës së paditur). Interesi për një rezultat të përbashkët e përngjason marrëdhënien ‘thirrës – i thirrur’ me atë ‘ndërhyrës dytësor – palë e mbështetur’.

Përcaktimi i personit të tretë nga paditësi në tekstin e kërkesëpadisë së dorëzuar prej tij në gjykatë, nuk merret i mirëqenë nga gjykata, por në rastin më të parë që procedura e lejon (në seancën përgatitore), gjykata merr vendim të ndërmjetëm në vështirësi të neneve 158/a, 192, 194 të Kodit, me të cilin pranon ose refuzon marrjen pjesë të të tretit në gjykim, duke u nisur nga fakti nëse përmbushen ose jo kriteret ligjore për këtë (‘*çështja e përbashkët*’ ose ‘*kërkesa e garancisë*’).<sup>9</sup>

### **Çështja e përbashkët mes palës dhe të tretit (n. 192 i K.P.C.).**

Secila palë mund të thërrasë në gjykim një person të tretë me të cilin e ka të përbashkët çështjen. Për shembull paditësi që i drejtohet gjykatës me padinë sipas n. 296 të K.C. (‘*padia për kërkimin e sendit*’) e ka të përbashkët çështjen me bashkëpronarët e tjerë të sendit të përbashkët. Pasi e nis procesin i vetëm në rolin e paditësit (*kjo padi mund të ngrihet qoftë edhe vetëm nga njëri prej bashkëpronarëve, duke mos qenë bashkëndërgjyqësia, e detyrueshme në këtë rast, por e thjeshtë*), gjatë procesit paditësi thërret si persona të tretë të gjithë bashkëpronarët. Në një shembull tjetër, njëri prej debitorëve solidarë që paditet për përmbushjen e detyrimit, duke u thirrur vetëm ai si i paditur në gjykim, thërret si persona të tretë debitorët e tjerë solidarë.<sup>10</sup> Në të dyja këto raste bashkëndërgjyqësia midis palës dhe personave të tretë nuk është e detyrueshme (e domosdoshme) sipas ligjit, që do të thotë se procesi do të mund të kishte vazhduar rregullisht edhe pa praninë e të tretëve.

Ashtu siç ka theksuar edhe jurisprudenca vendase e ligjshmërisë, ‘karakter i përbashkët i çështjes’ si kriter për thirrjen e të tretit nga pala, përkon me konceptin e ‘bashkëndërgjyqësisë’ në kuptim të n. 161 të K.P.C..<sup>11</sup> Ndërsa doktrina e ka cilësuar si thirrja e personit që nuk ka pranuar apo nuk mund të detyrohet nga paditësi që t’i bashkohet atij në të njëjtën cilësi (bashkëndërgjyqësi aktive), ose e personit që paditësi nuk ka dëshiruar të disponojë për ta thirrur si të paditur dhe as nuk mund të detyrohet prej të paditurit që të disponojë për ta thirrur në këtë cilësi (bashkëndërgjyqësi pasive).<sup>12</sup>

Është në disponimin e lirë të palës të thërrasë ose jo persona të tretë sa herë që ajo e çmon të dobishme për mbrojtjen e interesave të saj në gjykim. Theksojmë se thirrja e të tretit mbi bazën e ekzistencës së një çështjeje të përbashkët midis thirrësit dhe të thirrurit, mund të gjejë zbatim vetëm në rastin e ‘bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë’. Tek ‘bashkëndërgjyqësia e detyrueshme’ i treti nuk mund të vijë në gjykim si subjekt procedural pa pozitën e palës, por duhet të paraqitet në gjykim me cilësinë e paditësit ose të paditurit, në krah të palës me të cilën e ka të përbashkët çështjen. Si rast tipik i ‘bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme’ mund të merret ai i bashkëtëpaditurve tek padia e pjesëtimit të sendit të përbashkët (n. 207 i K.C.), në të cilën ligjvënësi përdor frazën ‘*duke u thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët*’. Nëse një paditës ‘i shkujdesur’, gabimisht nuk i jep cilësinë e palës një personi, por atë të ‘personit të tretë’, atëherë kur formimi i ndërgjyqësisë

diktohet nga ligji në mënyrë të ngurtë, kjo do të përbënte një ndërgjyqësi të formuar jo në mënyrë të drejtë. Sanksioni procedural me të cilin do të ndeshej paditësi në këtë rast do të ishte një vendim jo përfundimtar, që do t'i jepte fund procesit pa e zgjidhur çështjen në themel, në vështrim të n. 127 të K.P.C..

Në Vendimin nr. 315, datë 21.05.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë u përball me një çështje, ku paditësi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së një veprimi juridik (kontrate shitjeje), gabimisht nuk kishte thirrur si të paditur të dyja palët në kontratën e shitjes, por vetëm njërin prej tyre dhe palën tjetër si person të tretë. Kjo situatë 'u ndëshkua' nga gjykata e ligjshmërisë, si formim jo i drejtë i ndërgjyqësisë në kuptim të n. 467, shkronja 'd' të Kodit. Kjo pasi 'bashkëndërgjyqësia e detyrueshme' nuk është e thënë të parashikohet veçse shprehimisht nga ligji (si në nenin 207 të K.C.), por në shumicën e rasteve rezulton qartë nga natyra e mosmarrëveshjes.

### **'I treti garantues' (n. 192 i K.P.C.).**

Kjo figurë procedurale përcaktohet si dikush, të cilin paditësi ose i padituri mund ta thërrasë në gjykim për t'u garantuar prej tij në lidhje me përfundimin e çështjes; e ashtuquajtura 'thirrje e të tretit për garanci'. Në doktrinë kjo njihet si 'denoncimi i padisë' (*litis denuntiatio*), me çka duhet kuptuar se i padituri e thërret të tretin në përmbushje të një detyrimi të vendosur nga ligji material; në mungesë të thirrjes, i padituri rrezikon të pësojë humbje në pozitën e të drejtave të tij subjektive. Në këtë rast pala thirrëse (i garantuari) synon të mbajë të pacenuar pozitën e tij në rast humbjeje të procesit gjyqësor, dhe për këtë qëllim kërkon të mbështetet tek garantuesi. I tillë është rasti i dorëzanësit, i cili pasi paditet nga kreditori, thërret si person të tretë garantues debitorin kryesor; ose i debitorit solidar, që thërret si persona të tretë garantues debitorët e tjerë. Këto situata mbështeten në një marrëdhënie specifike materiale (thelbësore), që i njeh të garantuarit të drejtën e një padie kthimi (regresi) ndaj garantuesit, për gjithçka që i garantuari mund të detyrohet t'i përmbushë kundërshtarit në çështjen gjyqësore kryesore.<sup>13</sup> Në këtë rast i treti nuk ka detyrime procedurale ndaj palës thirrëse, por pozita e tij substanciale paraqet pika të veçanta lidhjeje me atë të thirrësit.<sup>14</sup> Si të tilla këto përbëjnë të ashtuquajturën 'garanci e thjeshtë ose personale'. Raste të tjera garancie (të quajtura 'formale ose reale') mbështeten në transferimin me titull të prejardhur (derivativ) të një sendi, për të cilin i garantuari përballet me kundërshtimin e palës tjetër në çështjen gjyqësore kryesore. Si e tillë shërben për shembull, garancia për eviksion sipas n. 728 të K.C.<sup>15</sup>, e përdorur nga i garantuari (blerësi) kundër garantuesit (shitësi). Në këtë rast garantuesi jo vetëm duhet të mbajë të paprekur pozitën e të garantuarit nga pikëpamja e të drejtës civile materiale, por ka edhe detyrimin për të marrë përsipër mbrojtjen procedurale.<sup>16</sup>

Nëse garantuesi paraqitet në gjykim, mund të bjerë dakord me të garantuarin dhe me palën kundërshtare, që i garantuari të largohet nga gjykimi. Ky nuk është një largim i mirëfilltë – në këtë rast Kodi përdor shprehjen "duke u përfaqësuar në gjykim i garantuari nga garantuesi", duke nënkuptuar përfaqësimin (mbrojtjen) e interesave të të garantuarit. Edhe pse veprimet procedurale të garantuesit nuk sjellin pasoja drejtpërdrejt për të garantuarin (si në rastin e një marrëdhënieje tipike përfaqësimi), rezultati përfundimtar i procesit i kundrejtohet të garantuarit njësoj sikur ai të mos ishte larguar nga gjykimi. Kjo pasi Kodi parashikon (n. 197) se vendimi përfundimtar i gjykatës mbi themelin e çështjes e shtrin efektin edhe ndaj personit të garantuar.

Lind pyetja: çfarë bëhet me 'kërkimin e shpërblimit të tretit', si rrethanë për thirrjen e të tretit sipas n. 192 të Kodit? Është më tepër një 'relike' e mbetur nga Kodi i Procedurës Civile i vitit 1958, i

cili në nenin 127 parashikonte se bashkë me kërkesën për thirrjen e të tretit, thirrësi krijonte një ndërgjyqësi të re duke paraqitur padi kundër të tretit për kërkimin e shpërblimit. Realizimi konkret procedural i kësaj rrethane paraqet vështirësi gjyqësore, nisur edhe nga fakti se, ngrihet një padi ‘anomale’, e cila mbështetet në një fakt procedural të pasigurt (nuk dihet nëse pala që kërkon shpërblimin, do ta humbasë apo jo çështjen).

### **I treti i thirrur nga gjykata (n. 193 i K.P.C.).**

Në raste të veçanta, gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë në gjykim. Themë ‘raste të veçanta’ nisur nga bindja se parimisht formimi i ndërgjyqësisë është disponim i paditësit, me rregullime të caktuara që bëhen edhe nga i padituri, për të tretët që ky i fundit mund të thërrasë në proces. Iu takon palëve ta ngrenë dhe çojnë përpara procesin gjyqësor, ndërsa gjykatës të mbikëqyrë qëndrimin procedural të palëve në këtë drejtim. Por në raste të veçanta, palët mund të tregohen pasivë, të shkujdesur ose të paimpënjësues, për të siguruar pjesëmarrjen në gjykim të subjekteve (personave të tretë) të drejtat subjektive të të cilëve ndikohen nga objekti i gjykimit. Mosveprimi i palëve në këtë kuadër ‘shërohet’ nga njëfarë aktivizimi relativ i gjykatës. Sigurisht gjykata nuk mund të zëvendësojë vullnetin e palës në këtë proces, vullneti i gjykatës nuk i mbivendoset atij të palës kurdo e në çdo rast. Vetëm kur gjatë gjykimit vihen në diskutim rrethana të lidhura me të drejtat subjektive të personave që mungojnë në proces, gjykata i thërret ata në gjykim.

Qëllimi i thirrjes së të tretit nga gjykata, tejkalon interesin e palëve dhe i shërben realizimit të ekonomisë gjyqësore (procedurale) dhe parandalimit të gjykimeve kundërtshënës në çështje të karakterizuara nga elemente të përbashkët.<sup>17</sup>

Kodi në nenin 193 përdor frazën – rezulton se i treti, për të cilin gjykata procedon me thirrjen, *ka interes në çështje*. Interesi i tij është si i çdo të treti tjetër, me karakter potencial, jo i drejtpërdrejtë dhe aktual aq sa për të nevojitur thirrjen e tij si palë e mirëfilltë në proces. Interesi i të tretit për të marrë pjesë nuk rrjedh nga efektet (pasojat) e drejtpërdrejta që vendimi gjyqësor përfundimtar do të mund të ketë ndaj tij, por përkundrazi nga efekte me natyrë ‘të reflektuar’ ndaj të tretit, d.m.th. kur pasojat e drejtpërdrejta që vendimi gjyqësor ka ndaj palëve pritet të reflektohen në të ardhmen tek personi i tretë.<sup>18</sup> Gjykatës nuk i lejohet të thërrasë si të tretë, persona të cilët do të duhet të ishin paraqitur si bashkëpaditës apo të ishin thirrur si të paditur nga paditësi. Pra gjykata nuk mund të ndikojë në formimin e ndërgjyqësisë. Të tretit të thirrur nga gjykata i jepet mundësia të njihet me faktin se në një gjykatë të vendit është duke u zhvilluar një gjykim, që mund të paraqesë interes për të. Fundja ekzistencën ose jo të interesit të tij subjektiv, mund ta përcaktojë vetëm i treti, duke pranuar apo jo të bëhet pjesë e procesit. Veprimi i gjykatës në këtë rast është ai i një ‘kontradiktoriteti të jashtëm’ – të tretit i jepet kësaj mundësie të thotë fjalën e tij në proces.

Edhe pse ky i tretë sipas n. 193 të Kodit, nuk është thirrur nga pala, nuk përjashtohet mundësia që ai eventualisht të mbështesë apo kundërshtojë, tërësisht apo pjesërisht, qëndrimet e njëres apo tjetres palë, ose të të dyja palëve njëkohësisht. I tretë sipas n. 193 është një figurë e posaçme, e cila nuk ka pse të kategorizohet skematikisht në përngjasim të ‘ndërhyrësit kryesor’ apo të ‘të thirrurit prej palës’. Kodi duke përcaktuar se ‘ai ka interes në çështje’ nuk ka përcaktuar kritere lidhëse midis interesit të tij dhe interesit të palëve; kjo lidhje mund të jetë e një natyre të shumëllojshme në varësi të natyrës së çështjes konkrete, dhe si e tillë e pakategorizueshme paraprakisht. Në të kundërt ligjvënësi do të kishte qenë më i qartë, ashtu siç ka bërë me kritere konkrete sa u takon

marrëdhënieve të interesave midis të tretit dhe palës, në nenet 189, 191, 192 të Kodit.

Verifikimi nëse është apo jo rasti për të proceduar gjykata kryesisht me thirrjen e të tretit, nuk është një aspekt që mbetet në diskrecionin e pakushtëzuar të gjykatës së shkallës së parë. Sigurisht që palët nuk do të mund të ngrinin pretendime procedurale në këtë drejtim, pasi po të qe për ta, do ta kishin kërkuar thirrjen e të tretit me kërkesë të tyre. Neglizhimi i gjykatës për të thirrur të tretë, interesi i të cilëve rezulton nga aktet e procesit, është vlerësuar rëndom nga gjykatat e shkallëve të tjera (e apelit, e Lartë) si një situatë e ‘formimit jo të drejtë të ndërgjyqësisë’ në kuptim të n. 467, shkronja ‘d’ të Kodit.

### **I treti pretendues (neni 198 i K.P.C.).**

"I treti pretendues" është një person, i cili, i ndodhur jashtë një gjykimi që po zhvillohet mes dy palëve të tjera, ka shfaqur pretendime për përkatësinë e tij mbi shumën, sendin, të drejtën reale ose përmbushjen e detyrimit tjetër, për të cilat zhvillohet gjykimi mes dy palëve ekzistuese. Figura e ‘të tretit pretendues’ konstituohet në gjykim me nismën e të paditurit. Ky i fundit e thërret të tretin në gjykim, me synimin që çështja të gjykohet midis paditësit dhe të tretit, i padituri (i mëparshëm) të dalë jashtë gjykimit dhe gjykimi të vazhdojë midis paditësit dhe personit të tretë, i cili tashmë merr rolin e të paditurit të ri dhe të vetëm në proces.

Doktrina ka pasur rast të theksojë se: *“Dalja jashtë gjykimit, parë nën një këndvështrim konceptual, është fenomen i kundërt me atë të ndërhyrjes, pasi ka të bëjë me daljen nga procesi të një pale.”*<sup>19</sup>

Në këtë rast i padituri i mëparshëm është i gatshëm të paguajë shumën, dorëzojë sendin, njohë të drejtën reale ose përmbushë detyrimin tjetër, për të cilat ai është paditur, por nuk është i sigurt se kujt duhet t’ia përmbushë këtë detyrim. Për këtë qëllim i padituri i mëparshëm aktivizon proceduralisht ‘të tretin pretendues’. Ky i fundit ka interes të kundërshtojë përmbushjen e detyrimit apo njohjen e të drejtës reale dhe kjo përbën arsyen e pjesëmarrjes së tij në proces.

Kushti bazë që e dallon thirrjen në proces të ‘të tretit pretendues’ (n. 198) nga thirrja e personit të tretë me kërkesë të palës (n. 192), është se, i padituri i deriatëhershëm e përmbush efektivisht detyrimin për të cilin ai është paditur, kjo pasi në thelb midis tij dhe paditësit nuk ka përplasje të drejtash subjektive. Sendi apo shuma objekt gjykimi do të mbeten në dispozicion të përkohshëm të gjykatës dhe asnjëra prej palëve nuk do të mund të ketë të drejta mbi to përpara dhënies së vendimit gjyqësor përfundimtar. Gjykata mbikëqyr përmbushjen e detyrimit nga i padituri i deriatëhershëm dhe fill pas kësaj e lejon të paditurin e deriatëhershëm të dalë jashtë gjykimit, duke humbur sakaq statusin e palës (të paditurit). Në këtë moment procesi vendoset në një udhëkryq: ose ‘i treti pretendues’ do të kërkojë që pretendimet e tij të deriatëhershme jashtëgjyqësore t’i shoqërojë me vullnetin procedural për t’u ‘ndeshur’ me paditësin mbi objektin e gjykimit (rasti i parë); ose përkundrazi, ‘i treti pretendues’ do të refuzojë të përfshihet në proces, duke mos i bërë të ditura gjykatës prapësime të tijat mbi objektin e gjykimit (rasti i dytë).

Në rastin e parë, vetëm pas "ndeshjes" së palëve mbi objektin e gjykimit, vendimi përfundimtar do të përcaktojë, nëse do të pranohet padia dhe sendi apo shuma t’i kalojë paditësit, apo nëse do të rrëzohet padia e paditësit. Në këtë rast të fundit, mund të ekzistojnë dy interpretime: sendi apo shuma t’i kalojë drejtpërdrejt të paditurit, për shkak se i padituri i mëparshëm, si zotërues i sendit apo shumës, bashkë me përcaktimin e personit që do ta suksedonte proceduralisht, në mënyrë implicite ka përcaktuar se po ai person do ta suksedonte automatikisht edhe në të drejtat subjektive. Interpretimi i dytë alternativ, nuk i jep të drejta automatike të paditurit të ri mbi sendin

apo shumë në rast rrëzimi të padisë, por lë të hapur mundësinë për të që gjatë gjykimit të paraqesë kundërpadi duke kërkuar njohjen e të drejtave të tij mbi sendin apo shumë.

Në rastin e dytë, vendoset pushimi i çështjes dhe shuma e derdhur ose sendi i depozituar i dorëzohen paditësit.

### **Të drejtat procedurale të personit të tretë (n. 195 i K.P.C.).**

Në këndvështrimin tonë dispozitës së nenit 195, paragrafi i parë<sup>20</sup>, të K.P.C., i duhet dhënë një interpretim ngushtues. Kjo pasi është e qartë se Ndërhyrësi kryesor mund të kryejë jo vetëm çdo veprim procedural të lejuar për palët e tjera, por ai mundet ndaj padisë së ngritur prej tij, që në aspektin formal përbën padi të re (në kuptimin e veçantë nga ajo e mëparshme), të kryejë veprime procedurale që përbëjnë disponim të objektit të padisë të ngritur prej tij. Thënë kjo, është e qartë se në lidhje me padinë që ai ka gjetur në gjykim e sipër, që është padia e paditësit tjetër të mëparshëm, ai nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural nga ato që ligji ia rezervon paditësit.

Në veprimet që përbëjnë disponim të objektit të padisë futen padyshim ato për ndryshimin e shkaktuar ligjor dhe të objektit të padisë (n. 185 i K.P.C.), si dhe çdo veprim tjetër procedural nga ato që ligji ia rezervon shprehimisht paditësit (ndër të tjera mund të përmendim ndryshimin e ndërgjyqësisë n. 154 dhe 161 të K.P.C.; mosparaqitjen pa shkak të arsyeshëm në seancë, e ashtuquajtura braktisje e gjykimit, si mënyrë për pushimin e gjykimit për shkak të mosveprimit të paditësit n. 179 K.P.C.; etj.).

Nga ana tjetër, duket se parashikimi i paragrafit të parë të nenit 195 të K.P.C. i qëndron më nga afër përshtat kufizimit të të drejtave procedurale të ndërhyrësit dytësor. Është ndërhyrësi dytësor, që duke u përfshirë si subjekt ndihmës (mbështetës) në një gjykim të filluar mes personash të tjerë, i bashkohet njëres palë për të garantuar një interes të ligjshëm të tij që do të prekej pa garanci kontradiktoriteti në rast mospjesëmarrjeje të tij në gjykim. Pozita e të tretit në këtë rast është e anësuar ndaj palës që ai mbështet; të drejtat e tij procedurale janë të kufizuara në atë masë sa nuk pengojnë, dëmtojnë apo vështirësojnë garancitë procedurale të parashikuara nga ligji për palën që ndërhyrësi dytësor mbështet. Çdo veprim i të tretit mund të lejohet vetëm në harmoni me qëndrimin dhe interesat e palës që ai mbështet. Në këtë kuptim të tretit nuk i njihen shumë prej veprimeve që i takojnë palës që ai mbështet, qoftë kjo e fundit paditës ose i paditur. P.sh., nuk ka ndalesë për ndërhyrësin dytësor të kërkojë sigurimin e ndonjë prove (n. 292 e vijues të K.P.C.); edhe pse ligji nuk e trajton këtë çështje posaçërisht për të drejtat e personit të tretë me këtë rast, ky veprim do të lejohej nëse prova e kërkuar të merrej nuk do të vinte ndesh me interesat e palës së ndihmuar prej të tretit dhe qëndrimin të shprehur posaçërisht nga pala përkatëse kur të pyetej për marrjen e provës.

Si përgjithësim mund të themi se, edhe për ato veprime procedurale që në interpretim rast pas rasti do të vlerësohej se nuk përbëjnë disponim të objektit të padisë, kërkesa e ndihmës dhe mbështetjes nuk do të përmbushej nëse veprimi përkatës do të kundërshtohej nga pala e ndihmuar si i tillë që pretendohet se nuk do të vinte në ndihmë të garantimit të të drejtave dhe interesave të saj. Një veprim në kundërshtim me interesat e palës së ndihmuar do të vinte në kundërshtim me kriterin e ndihmës dhe mbështetjes sipas n. 191 të K.P.C., dhe proceduralisht nuk do të duhej të lejohej të kryhej pas kërkesës së ndërhyrësit dytësor.

**Mbi detaje të marrëdhënies procedurale midis ndërhyrësit dytësor dhe palës që ai mbështet.**

Kjo pjesë e punimit i kushtohet posaçërisht argumentimit, nëse ndërhyrësi dytësor mundet ose jo ta ndjekë çështjen, në rrethanën kur pala e mbështetur prej tij ka humbur ajo vetë interesin për ta bërë këtë. Ky shqyrtim do të bëhet para së gjithash nga këndvështrimi i ushtrimit ose jo nga palët e përfshira, të ankimit kundër vendimit përfundimtar të gjykatës, drejtuar shkallës pasardhëse të gjykimit.

Në rastin e ndërhyrjes kryesore është vetë përmbajtja e n. 189 të K.P.C. që flet shprehimisht për ngritje të padisë nga ndërhyrësi kryesor. Ky i fundit, duke qenë se paraqitet si paditës i ri, kundër njëres apo të dy palëve, parimisht ruan të drejtën të paraqesë ankim kundër vendimit përfundimtar të gjykatës të marrë pas ndërhyrjes së tij.

Pozita e ndërhyrësit kryesor është autonome nga ajo e palëve. Nëse në kuadrin e padisë bazë padisë së ngritur përpara ndërhyrjes së ndërhyrësit kryesor vendoset pushimi i gjykimit, gjykimi i çështjes në kuadër të padisë së ndërhyrësit kryesor, do të vazhdojë rregullisht.

Në rast se pas ankimit/ankimeve të palës/palëve (paditësit dhe të paditurit të mëparshëm) të konstituara para ndërhyrjes kryesore të të tretit, pala ankuese kërkon heqjen dorë nga ankimi ose rekursi (sipas n. 463 dhe 490 të K.P.C.), gjykata e apelit apo e Lartë vendos pushimin e gjykimit dhe mbetet në fuqi vendimi përfundimtar i shkallës së mëparshme të gjykimit. Pushimi i gjykimit në këtë rast për padinë bazë, nuk pengon vazhdimin e gjykimit për padinë e ndërhyrësit kryesor, në rast se ky i fundit kishte paraqitur ankim kundër vendimit përfundimtar të shkallës së mëparshme të gjykimit. Pra heqja dorë nga ankimi/rekursi nga paditësi/i padituri bazë (i mëparshëm), nuk i shtrin efektet edhe ndaj ankimit/rekursit të paraqitur nga ndërhyrësi kryesor.

Në rast të ndërhyrjes dytësore, pozita procedurale e të tretit është ajo e një mbështetësi ose ndihmësi të palës përkatëse me të cilën bashkohet në gjykim. Rast klasik i ndërhyrjes dytësore mund të jetë ai i nënqiramarrësit, që paraqitet si i tretë në gjykimin midis qiradhënësit dhe qiramarrësit (mundësisht duke iu bashkuar këtij të fundit në gjykim). I tretë në këtë rast ka një interes të ligjshëm, që mund të preket nga gjykimi në vazhdim dhe vendimi përfundimtar përkatës, dhe është ky interes që përbën justifikimin objektiv për pjesëmarrjen e tij në gjykim. Mbi bazën e këtij interesi, ai mundet eventalisht të kundërshtojë me ankim vendimin përfundimtar të shkallës së parë apo të dytë.

Trajtimi ligjor i ndërhyrjes së të tretit në një proces gjyqësor civil, në format e ndryshme të saj, ka ngjashmëri të theksuara në rendin juridik italian dhe atë shqiptar. Mbi bazën e parashikimeve ligjore analoge në të dyja rendet, dhe më gjerë të linjave kryesore të ngjashme për zhvillimin e gjykimit, mund të na vijë në ndihmë përfundimi i arritur nga Gjykata e Kasacionit në Itali si vijon:

*“Është i papranueshëm rekursi në kasacion i paraqitur nga pala që në gjykimin e faktit ka kryer ndërhyrje të bashkëngjitur të varur; nëse pala e ndihmuar nga ndërhyrësi dytësor ka pranuar qoftë edhe në heshtje vendimin e kundërshtuar nga i tretë, me argumentin se ky ndërhyrës përligjet të ndërmarrë vetëm nisma me karakter anësor dhe të varur ndaj atyre të marra nga pala e ndihmuar.”<sup>21</sup>*

Nga fragmenti i mësipërm theksojmë se “ndërhyrja e bashkëngjitur e varur” i përgjigjet asaj që në Kodin e Procedurës Civile të R.Sh. trajtohet si “ndërhyrje dytësore”. Nga analiza edhe e qëndrimit të gjykatës së huaj, mund të shprehemi se, kur pala e ndihmuar nga ndërhyrësi dytësor ka hequr dorë nga ankimi, ankimi i të tretit (ndërhyrësit dytësor) nuk mund të pranohet. Thënë kjo, pothuajse me të njëjtën shkallë sigurie mund të arrihet edhe në konkluzionin se, kur heqja dorë nga ankimi ose mosankimimi kryhet nga pala kundërshtare e të tretit dhe pala e ndihmuar nga i

treti nuk paraqet ankim, ankimi i të tretit nuk mund të pranohet. Nga sapo thamë, duket sikur i tretë mund të paraqesë ankim vetëm kur paraqet njëkohësisht ankim në shkallën përkatëse të gjykimit edhe pala e ndihmuar. Ky pohim i sapoarritur me karakter përgjithësues është pothuajse i vërtetë. Në sens të kundërt mund të kishte ndonjë shpresë për të mos konsideruar të papranueshëm ankimin e të tretit, kur pala kundërshtare ka paraqitur ankim, ndërsa pala e ndihmuar s'ka paraqitur ankim.

Në një situatë tjetër në harmoni me pohimin përgjithësues të sipërpërmendur, nëse gjatë gjykimit në shkallë të parë, paditësi heq dorë nga gjykimi dhe ndërhyrësi dytësor i është bashkuar cilëso prej palëve paditëse ose të paditur, gjykimi pushohet, duke u përjashtuar rrjedhimisht edhe pjesëmarrja e mëtejshme e të tretit në një gjykim tashmë të pushuar për çdo efekt dhe subjekt. Kjo logjikë që vlen gjatë ecurisë së gjykimit në shkallë të parë, nuk ka pse të mos zbatohet edhe gjatë qëndrimit të çështjes në gjykatën e apelit apo të Lartë, përndryshe do të cungohej disponibiliteti i padisë nga paditësi dhe disponibiliteti i gjykimit nga të dyja palët kryesore (në lidhje me ankimimet), dhe do të cenohej në analizë të fundit karakteri thelbësor i mirëfilltë i procesit gjyqësor civil.

### **Efektet e vendimit përfundimtar ndaj personit të tretë (n. 196 i K.P.C.).**

*“Vendimi që jepet pas ndërhyrjes dytësore ose thirrjes së personit të tretë ka efekt kundrejt tij si për sa u përket marrëdhënieve të tij me personin që e ka thirrur ose për të cilin ka ndërhyrë për ta ndihmuar, ashtu dhe për sa u përket marrëdhënieve të tij me anën kundërshtare.”* Efektet e vendimit përfundimtar ndaj personit të tretë janë të kufizuara, në çdo rast të një natyre të veçantë, krejt specifike. Ç’duam të themi me këtë? Personi i tretë, duke mos qenë ‘palë’ në kuptimin e ngushtë, të mirëfilltë të fjalës, nuk mund të ngarkohet me detyrime, sipas vendimit përfundimtar të gjykatës, në dispozitiv (pjesën urdhëruese) të vendimit. Pra gjykata nuk mund të shprehet as për rrëzim të padisë së personit të tretë (sepse në fakt padia nuk është e tija), as për ngarkimin e të tretit me këtë apo atë detyrim së bashku apo veçmas nga pala e paditur. Personi i tretë nuk mund të jetë pjesë e urdhërimeve të gjykatës.<sup>22</sup>

Sa u takon përfundimeve në të cilat ka arritur gjykata, duke zgjidhur mosmarrëveshjen mes palëve, duke përcaktuar se cila palë ka të drejtë dhe cila ka faj në mosmarrëveshjen e shqyrtuar, duke ‘çimentuar’ një version të fakteve dhe të të drejtave korresponduese midis palëve, këto përfundime të gjykatës janë të tilla që, edhe pse jo drejtpërdrejt të detyrueshme për të tretin, sjellin për të pasoja të caktuara. Këto pasoja përbëjnë të ashtuquajturat ‘efekte të vendimit përfundimtar kundrejt personit të tretë’ sipas n. 196 të Kodit.

Këto pasoja janë në gjendje potenciale dhe shndërrohen në efektive vetëm kur, pala thirrëse ose e mbështetur, me të dalë e pakënaqur (humbëse) nga çështja gjyqësore kryesore, ku i tretë u thirr ose ndërhyri, inicion një proces tjetër gjyqësor, kësaj here duke i kundërtuar të tretit të drejtat dhe interesat e saj (palës thirrëse ose të mbështetur), të cilat rezultuan të cenuara nga mënyra e përfundimit pa sukses të çështjes gjyqësore kryesore. Përpjekja për të shmangur humbjen, nga pala thirrëse ose e mbështetur, të çështjes gjyqësore kryesore, përbën interesin e të tretit për të marrë pjesë në gjykimin e asaj çështjeje ku ai nuk figuron formalisht si palë. Në këtë rast i tretë është i detyruar të pranojë përfundimet e arritura nga gjykata në fund të procesit gjyqësor kryesor, përfundime të cilat kanë të bëjnë me rrethana që e lidhin të tretin si me njërin ashtu edhe me tjetrën palë të procesit kryesor. Ja arsyeja sepse Kodi përcakton efektshmërinë e zgjidhjes së dhënë nga gjykata në çështjen gjyqësore kryesore për marrëdhëniet e të tretit me secilën prej palëve të asaj çështjeje.

### Përfundime.

Personi i tretë është një subjekt i procesit civil me rol të kufizuar, të drejtat procedurale të të cilit nuk shtrihen deri në disponimin e gjykimit apo të objektit të padisë. Raporti midis një çështjeje gjyqësore kryesore dhe mundësisë së një çështjeje gjyqësore pasardhëse, shënon karakteristikën bazë të zhvillimit kronologjik të marrëdhënieve procedurale midis palës dhe personit të tretë.

Lidhja e ndërhyrësit kryesor është me sendin ose të drejtën përkatëse, nuk është një lidhje midis dy kërkimeve (atij që ndërhyrësi gjen në proces dhe atij që ai parashtrohet rishtas). Pozita e ‘ndërhyrësit dytësor’ krahasimisht është më e ulët (inferiore), sesa ajo e ‘ndërhyrësit kryesor’.

Pika përbashkuese midis ‘ndërhyrësit dytësor’ dhe ‘të thirrurit nga pala’ është se ata nuk parashtrojnë kërkime të drejtpërdrejta të vetat ndaj objektit të gjykimit (sendit ose të drejtës). Megjithatë, midis të dyja figurave ka një ndryshim me rëndësi. I thirruri shfaq një pavarësi relative më të madhe nga pala thirrëse sesa ajo që shfaq ndërhyrësi dytësor nga pala e mbështetur prej tij.

Kur si shkak për thirrjen e të tretit nga pala shërben ekzistenca e një çështjeje të përbashkët, thirrja mund të gjejë zbatim vetëm në rastin e ‘bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë’. Tek ‘bashkëndërgjyqësia e detyrueshme’ i treti nuk mund të vijë në gjykim si subjekt procedural pa pozitën e palës, por duhet të paraqitet në gjykim me cilësinë e paditësit ose të paditurit, në krah të palës me të cilën e ka të përbashkët çështjen.

Në të ashtuquajturën thirrje e të tretit për garanci, paditësi ose i padituri mund ta thërrasë të tretin në gjykim për t’u garantuar prej tij në lidhje me përfundimin e çështjes. Garancia e thjeshtë ose personale mbështetet në një marrëdhënie specifike materiale (thelbësore), që i njeh të garantuarit të drejtën e një padie kthimi (regresi) ndaj garantuesit. Raste të tjera garancie (formale ose reale) mbështeten në transferimin me titull të prejardhur (derivativ) të një sendi, për të cilin i garantuari përballlet me kundërshtimin e palës tjetër në çështjen gjyqësore kryesore.

Nëse garantuesi paraqitet në gjykim, mund të bjerë dakord me të garantuarin dhe me palën kundërshtare, që i garantuari të largohet nga gjykimi. Ky nuk është një largim i mirëfilltë, pasi gjithsesi rezultati përfundimtar i procesit do t’i kundrejtohet të garantuarit njësoj sikur ai të mos ishte larguar nga gjykimi.

Thirrja e të tretit nga gjykata do të duhet të aplikohet vetëm në ‘raste të veçanta’. Veprimi i gjykatës në këtë rast është ai i një ‘kontradiktoriteti të jashtëm’ – të tretit i jepet kësaj mundësie të thotë fjalën e tij në proces. I treti sipas n. 193 është një figurë e posaçme, e cila nuk ka pse të kategorizohet skematikisht në përngjasim të ‘ndërhyrësit kryesor’ apo të ‘të thirrurit prej palës’.

Kushti bazë që e dallon thirrjen në proces të ‘të tretit pretendues’ (n. 198) nga thirrja e personit të tretë me kërkesë të palës (n. 192), është se, sipas n. 198 i padituri i deriatëhershëm është i gatshëm ta përmbushë efektivisht detyrimin për të cilin ai ishte paditur, kjo pasi në thelb midis tij dhe paditësit nuk ka përplasje të drejtash subjektive.

Kufizimi i të drejtave të personit të tretë vetëm në veprimet që nuk përbëjnë disponim të objektit të padisë, i qëndron më nga afër përshtat kufizimit të të drejtave procedurale të ndërhyrësit dytësor. Është ndërhyrësi dytësor, që duke u përfshirë si subjekt ndihmës (mbështetës) në një gjykim të filluar mes personash të tjerë, i bashkohet njëres palë, duke pasur të drejta procedurale të kufizuara.

Në lidhje me verifikimin nëse ekziston ose jo mundësia procedurale e ndërhyrësit dytësor për ta ndjekur çështjen, atëherë kur pala e mbështetur prej tij ka humbur ajo vetë interesin për ta bërë këtë (p.sh. duke hequr dorë nga ankimi), mbi bazën edhe të kontributit nga jurisprudenca e huaj është më i mbështetur qëndrimi sipas të cilit, vullneti i ndërhyrësit dytësor nuk do të ishte i mjaftueshëm

pa iu bashkëngjitur atij të palës që ai mbështet.

Personi i tretë, duke mos qenë ‘palë’ në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, nuk mund të ngarkohet me detyrime, sipas dispozitivit të vendimit përfundimtar të gjykatës. Por sa u takon përfundimeve në të cilat arrin gjykata në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, këto përfundime të gjykatës sjellin pasoja të caktuara për të tretin. Këto pasoja qëndrojnë në gjendje potenciale dhe shndërrohen në efektive vetëm kur, pala thirrëse ose e mbështetur, me të dalë e pakënaqur (humbëse) nga çështja gjyqësore kryesore, inicion një proces tjetër gjyqësor me kërkime që ia kundrejtton të tretit të mëparshëm (që tashmë rezulton i padituri i ri).

## Referenca.

- 1 Vendimi Unifikues nr. 74, datë 07.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- 2 Troci, K. Ndërhyrja dytësore e personit të tretë në procesin gjyqësor civil. Revista Avokatia, nr.16.
- 3 N. 160 i K.P.C.: “*Ipadituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi, kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi.*”
- 4 Troci, K. Ndërhyrja kryesore e personit të tretë, si lloj i ndërhyrjes vullnetare. Revista Avokatia, nr.8.
- 5 Brati, A. Procedura Civile. Tiranë, 2008; 137.
- 6 N. 192 i K.P.C.: “*Secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.*”
- 7 N. 193 i K.P.C.: “*Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë ...*”
- 8 Kola Tafaj, F., Vokshi, A. Procedurë Civile. Tiranë, 2013; 137.
- 9 Vendimi nr. 315, datë 21.05.2013, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 10 Comoglio, L.P., Consolo, C., Sassani, B., Vaccarella, R. Commentario del Codice di procedura civile. Vol. 2. UTET Giuridica, 2012; 118.
- 11 Vendimi Unifikues nr. 901, datë 14.07.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- 12 Lamani, A. Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë. Tiranë, 1962; 45.
- 13 Tarzia, G. Lineamenti del processo civile di cognizione. Giuffrè Editore, 2009; 183.
- 14 Lezioni di diritto processuale civile. ScriptaWeb, 2006; 267.
- 15 “*Blerësi, i paditur nga një i tretë që pretendon se ka të drejta mbi sendin e shitur, duhet ta thërrasë shitësin në çështje. Kur nuk e bën këtë dhe në dëm të tij është dhënë një vendim i formës së prerë, humbet të drejtën e garancisë për eviksion, në qoftë se shitësi provon se ekzistonin arsye të mjaftueshme për të refuzuar kërkesën. Blerësi që ka njohur vullnetarisht të drejtën e të tretit, e humb të drejtën e garancisë për eviksion, në qoftë se nuk provon se nuk ekzistonin arsye të mjaftueshme për të penguar marrjen e sendit.*”
- 16 Sassani, B. Lezioni di diritto processuale civile. ScriptaWeb, 2006; 296.
- 17 Ciavola, A., Maccarone, F. Il nuovo processo di cognizione davanti al tribunale. Halley Editrice, 2006; 39.
- 18 Cecchella, C. Processo Civile. Gruppo 24 Ore, 2012; 37.
- 19 Nuni, A., Vokshi, A. Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil. Revista Jeta Juridike; 2010, nr. 1; 21.
- 20 “*Personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë.*”
- 21 Vendimi nr. 3343, datë 06.03.2003, i Seksionit I Civil të Gjykatës Italiane të Kasacionit. Në të njëjtën linjë edhe Vendimi nr. 3616, datë 16.04.1994, i Gj.I.K., në të cilin i mohohet kjo mundësi ndërhyrësit dytësor, duke mos qenë ky i fundit titullar i marrëdhënies juridike që përbën objektin e mosmarrëveshjes. Shih: Grasselli, G. Il nuovo processo di cognizione. Cedam, 2012.
- 22 Kjo vlen edhe nëse të tretit (ndërhyrës dytësor ose i thirrur) kërkohet t’i akordohen të drejta me vendimin gjyqësor përfundimtar. Shih Vendimin Unifikues nr. 74, datë 07.10.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.